

LIGJ
Nr. 110/2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 10296, DATË 8.7.2010,
“PËR MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 3, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:
“Ky ligj zbatohet në njësitë publike, ku përfshihen.”.

Neni 2

Në nenin 4 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në fund të pikës 5 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:
“Njësia e qeverisjes qendrore përfshin organin qendror të njësisë dhe njësitë e varësisë, të kontrolluara prej saj.”.

2. Në fund të pikës 6 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:
“Njësia e qeverisjes vendore përfshin organin qendror të njësisë dhe njësitë e varësisë, të kontrolluara prej saj.”.

3. Në fund të pikës 7 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:
“Njësia e fondeve speciale përfshin organin qendror të njësisë dhe njësitë e varësisë, të kontrolluara prej saj.”.

4. Pika 8 ndryshohet si më poshtë:
“8. Të gjitha nivelet e njësisë publike ose njësi janë terma që u referohen njësive të përmendura në nenin 3, të këtij ligji, dhe nënkuptojnë organin qendror të njësisë publike dhe secilën njësi vartëse, të konsideruar më vete.”.

5. Pas pikës 19 shtohet pika 19/1 me këtë përmbajtje:
“19/1. “Veprimtaritë kryesore” janë ato veprimtari që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve, projekteve më të rëndësishme të saj.”.

6. Në fund të pikës 22 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:
“Në kuptim të këtij ligji, titullar i njësisë publike, që drejtohet me organe vendimmarrëse kolegjiale, por që nuk organizohet si shoqëri tregtare, konsiderohet ky organ.”.

7. Pas pikës 22 shtohet pika 22/1 me këtë përmbajtje:
“22/1. Titullar i njësisë në shoqëritë tregtare konsiderohet organi përgjegjës për përcaktimin e politikave të shoqërisë, sipas ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”.

8. Pas pikës 23 shtohet pika 23/1 me këtë përmbajtje:
“23/1. Nëpunës autorizues i nivelit të dytë dhe/ose i niveleve të tjera janë nëpunës të administratës publike në secilën nga njësitë vartëse, me buxhet më vete të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit të tyre, që përgjigjet përpara nëpunësit autorizues.”.

9. Në pikën 24, emërtimi “Nëpunës i nivelit të lartë menaxhues të njësisë” zëvendësohet me emërtimin “Nëpunës i nivelit menaxherial të njësisë”.

Neni 3

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 5

Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëritë shërbimeve publike. Ky sistem vendoset, ruhet dhe përditësohet rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihet në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- a) veprimtarive efektive, të efektshme dhe me ekonomi;
- b) pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- c) informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- ç) mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.”.

Neni 4

Në nenin 6, pika 1, pas shkronjës “e” shtohet shkronja “ë” me këtë përmbajtje:

“ë) funksionet dhe detyrat e strukturës përgjegjëse për financat në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.”.

Neni 5

Në nenin 8, pika 8, bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “a”, fjalët “hartimin e politiki-kave, miratimin dhe monitorimin e objektivave” zëvendësohen me fjalët “miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave”.

2. Shkronja “d” ndryshohet si më poshtë:

“d) propozimin e një strukture të përshtatshme organizative dhe vendosjen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësisë të tyre, përveç rasteve kur legjislacioni i posaçëm parashikon ndryshe;”.

Neni 6

Në nenin 9 bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Nëpunësi autorizues i njësisë publike, për efekt të menaxhimit financiar dhe kontrollit, cakton nëpunës autorizues të nivelit të dytë drejtuesit e programeve e nënprogrameve të çdo strukture dhe njësie të varësisë direkte, për të cilat identifikohet buxhet i veçantë. Në njësitë publike të përshkallë-zuara me disa nivele njësisish shpenzuese, nëpunësit autorizues caktohen nga organi epror direkt dhe emërtohen sipas nivelit të varësisë në nëpunës autorizues të nivelit të dytë, të tretë e të katërt.”.

2. Fillimi i fjalisë së parë, të pikës 3, ndryshohet si më poshtë:

“3. Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë të varësisë janë përgjegjës dhe raportojnë sipas shkallës hierarkike;”.

3. Shkronja “ç”, e pikës 4, shfuqizohet.

Neni 7

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 10

Përgjegjshmëria menaxheriale e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut

1. Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinator i riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike.

2. Në përmbushje të përgjegjësisë së tij, nëpunësi autorizues mund t'i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e koordinimin e riskut punonjësve, pjesë të strukturës së financës.

3. Përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.”.

Neni 8

Në nenin 12 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Nëpunës zbatues i njësisë publike është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat të njësisë publike, në varësi direkte nga nëpunësi autorizues i njësisë dhe që ka përfunduar studimet e ciklit të dytë në shkencat ekonomike ose zotëron diplomë universitare të ekuivalentuar me të, me përvojë pune jo më pak se pesë vjet në profesion. Nëpunësi zbatues emërohet në njësi, sipas kuadrit ligjor në fuqi, duke respektuar plotësimin e kërkesave të kësaj pike.”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Në njësitë publike të ndërtuara me më shumë se dy nivele varësie, punonjësit e financës në strukturat përgjegjëse të financave, të vendosur në nivelet e poshtme të varësisë, konsiderohen punonjës të deleguar të nëpunësit zbatues të njësisë nga varen. Punonjësit e financës, të vendosur në nivelet e poshtme të varësisë, duhet të kenë përfunduar të paktën studimet e ciklit të parë në shkencat ekonomike dhe raportojnë në mënyrë të dyfishtë te nëpunësi zbatues i njësisë nga varen dhe nëpunësi autorizues përkatës.”.

Neni 9

Në nenin 15, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Delegimi i të drejtave dhe i detyrave nuk cenon të drejtat e menaxherit dhe nuk e shkarkon atë nga përgjegjësia administrative për realizimin e objektivave, kontrollin e risqeve përkatëse apo për përzgjedhjen e vartësit, tek i cili delegohen të drejtat dhe detyrat. Delegimi kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.”.

Neni 10

Në nenin 16, pika 2, fjalët “të detajuara për procedurat kryesore” zëvendësohen me fjalët “për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë”.

Neni 11

Në nenin 18 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1, fjalët “sipas pikave 1 dhe 2, të nenit 3,” zëvendësohen me fjalët “sipas pikës 1, të nenit 3,”.

2. Në pikën 2, fjalët “fundi i muajit prill,” zëvendësohen me fjalët “fundi i muajit maj,”.

3. Pika 3 riformulohet si më poshtë:

“3. Ministri i Financave u paraqet Këshillit të Ministrave dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit, brenda muajit qershor të çdo viti, raportin vjetor për cilësinë dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm financiar publik për vitin paraardhës, përfshirë edhe gjetjet e rëndësishme dhe rekomandimet për përmirësimin e sistemit.”.

Neni 12

Në nenin 22, pika 3, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në fund të shkronjës “b”, fjalët “sipas udhëzimit të Ministrit të Financave” shfuqizohen.
2. Në fund shkronjës “c” shtohet fjalia me këtë përmbajtje:
“apo të nëpunësve të deleguar prej tyre sipas shkallës së riskut të lidhur me të, të vlerësuar për çdo angazhim.”.

Neni 13

Në nenin 25, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Ministri i Financave, në përmbushjen e detyrave të tij, sipas nenit 3, të këtij ligji, mbështetet nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, si pjesë e strukturës përgjegjëse për harmonizimin e kontrollit të brendshëm financiar publik. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e kontrollit të brendshëm financiar publik i raporton nëpunësit të parë autorizues dhe ministrit përgjegjës të financave.”.

Neni 14

Në nenin 26 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Pas shkronjës “d”, të pikës 1, shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje:
“dh) krijimin dhe përditësimin e regjistrit të nëpunësve autorizues dhe nëpunësve zbatues të njësive publike.”.
2. Pika 4 shfuqizohet.

Neni 15

Neni 28 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 28

Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik

1. Në Ministrinë e Financave ngrihet Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, me detyrën e mbikëqyrjes së çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm, në sektorin publik.
2. Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik përbëhet nga Ministri i Financave, në cilësinë e kryetarit të këtij bordi, nëpunësi i parë autorizues, drejtuesi i strukturës përgjegjëse për kontrollin e brendshëm financiar publik, drejtuesi i strukturës përgjegjëse për buxhetin, drejtuesi i strukturës përgjegjëse për thesarin, tre anëtarë të emëruar nga Ministri i Financave, me përvojë në fushat e menaxhimit financiar dhe kontrollit, kontabilitetit dhe auditimit të brendshëm.”.
3. Bordi shqyrton nevojën për miratimin e legjislacionit shtesë apo për përmirësimin e kuadrit rregullator të kontrollit të brendshëm financiar publik.
4. Bordi diskuton rreth raportit vjetor për kontrollin e brendshëm financiar publik para se të miratohet nga Ministri i Financave.
5. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e kontrollit të brendshëm financiar publik, në Ministrinë e Financave, siguron shërbimin e sekretariatit për veprimtarinë e bordit.
6. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të bordit miratohet me urdhër të Ministrit të Financave.
7. Masa e shpërblimit të anëtarëve të bordit dhe të sekretarit të bordit miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave.”.

Neni 16

Kudo në përmbajtjen e këtij ligji bëhen këto ndryshime:

1. Emërtim i “Njësia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” zëvendësohet me emërtimin “Struktura Përgjegjëse për Harmonizimin e Menaxhimit Financiar dhe

Kontrollit’.

2. Emërtimi “Njësi e sektorit publik” zëvendësohet me emërtimin “Njësi Publike”.

Neni 17

Dispozita kalimtare

Kërkesat e pikave 1 dhe 3.1, të nenit 12, do të përmbushen brenda një periudhe kalimtare dyvjeçare, deri në implementimin e kërkesave ligjore për nëpunësin zbatues.

Neni 18

Ngarkohet Ministri i Financave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 15.10.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9286, datë 23.10.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**